

LIGJ
Nr. 167/2020

**PËR FALJEN E DETYRIMEVE TË SIGURIMEVE SHOQËRORE, QË
ISH-PUNONJËSIT E NËNTOKËS KANË NDAJ INSTITUTIT TË SIGURIMEVE
SHOQËRORE, TË LLOGARITURA PËR PERIUdhËN QË KANË PËRFITUAR,
SIPAS LIGJIT NR. 8685, DATË 9.11.2000, “PËR NJË TRAJTIM TË VEÇANTË
TË PUNONJËSVE QË KANË PUNUAR NË MINIERA NË NËNTOKË”,
TË NDRYSHUAR, TË CILËT NJËKOHËSISHT KANË ZHVILLUAR AKTIVITET
EKONOMIK SI TË PUNËSUAR OSE VETËPUNËSUAR**

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 155 të Kushtetutës, me propozimin e një deputeti,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Objekti i ligjit

Ky ligj parashikon faljen e detyrimeve të papaguara që ish-punonjësit e nëntokës kanë ndaj Institutit të Sigurimeve Shoqërore për periudhën që ata janë trajtuar me përfitimet e caktuara, sipas ligjit nr. 8685, datë 9.11.2000, “Për një trajtim të veçantë të punonjësve që kanë punuar në miniera në nëntokë”, të ndryshuar, të cilët njëkohësisht kanë zhvilluar aktivitet ekonomik si të punësuar ose vetëpunësuar”.

Neni 2

Personat përfitues

Përfitojnë nga ky ligj të gjithë ish-punonjësit e nëntokës, që janë debitorë ndaj Institutit të Sigurimeve Shoqërore, të përcaktuar në nenin 4 të këtij ligji.

Neni 3

Personat që nuk përfitojnë

Nuk përfitojnë nga fshirja e detyrimeve të parashikuara sipas këtij ligji, personat përfitues për detyrimet që krijojnë pas datës së hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 4

Falja e gjobave

1. Falen gjobat e përlllogaritura nga sistemi i sigurimeve shoqërore, të llogaritura për periudhën që ata janë trajtuar me përfitimet e caktuara sipas ligjit nr. 8685, datë 9.11.2000, “Për një trajtim të veçantë të punonjësve që kanë punuar në miniera në nëntokë”, të ndryshuar, të cilët njëkohësisht kanë zhvilluar aktivitet ekonomik si të punësuar ose vetëpunësuar”, sipas gjendjes së papaguar deri në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

2. Falen detyrimet e vendosura, që janë evidentuar sipas pikës 1 të këtij neni, të cilat në momentin e hyrjes në fuqi të këtij ligji janë ankimuar dhe janë në proces ankimi administrativ ose në proces gjyqësor.

3. Periudhat e mbuluara me kontribute të derdhura për të cilat është likuiduar detyrimi i llogaritur nga përfitimi i paguar, do të njihen si periudha sigurimi për efekt të pensionit të pleqërisë.

Neni 5

Procedura e shuarjes së detyrimeve të falura nga ky ligj

Brenda 3 muajve pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, Instituti i Sigurimeve Shoqërore fshin detyrimet e përlllogaritura nga sistemi, të falura sipas këtij ligji, dhe bën pasqyrimet konkrete të fshirjes në regjistrat e tyre.

Lista e personave përfitues dhe vlera e detyrimit përkatës publikohen brenda 3 muajve në faqen zyrtare të Institutit të Sigurimeve Shoqërore dhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

Neni 6

Ngarkohet Ministri i Financave dhe Ekonomisë dhe Instituti i Sigurimeve Shoqërore që brenda 5 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji të zbatojnë të gjitha procedurat administrative dhe dokumentare të evidentimit të detyrimeve të falura.

Neni 7

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 23.12.2020.

Shpallur me dekretin nr.11902 , datë 5.1.2021, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta.